

LEGJISLACIONI NË FUQI DHE APLIKIMI



Korrik **2016**



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe i menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Evropian në Kosovë

RRETH PROJEKTIT

Projekti “Mbrotja e të drejtave të njeriut në epokën digjitale”, implementohet nga Shoqata për Privatësi, Teknologji dhe Media LENS si bartës dhe OJQ Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtarë/Kosovo Center for International Cooperation – QKBN/KCIC si bashkë zbatues. Projekti financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Zgjatë 20 muaj (janar 2016 – gusht 2017).

Qëllim i projektit është të adresoj cenimet e të drejtave të njeriut, lirive dhe demokracisë që janë shfaqur apo përkeqësuar në kohën e zhvillimit teknologjik në Kosovë. Projekti ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtave të privatësisë, lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave.

Hulumtimi “Legjislacioni në fuqi dhe aplikimi” është pjesë e aktiviteteve të këtij projekti. Ky hulumtim mbledhë dhe krahason legjislacionin mbi mbrojtjen e privatësisë dhe lirinë e fjalës. Ndërsa në shikim të parë duken si dy koncepte të ndryshme, ato janë në të vërtetë dy anët e së njëjtës medalje. Ky dokument në pjesë të parë adreson kryesisht këto ligje si elemente kyçe të kornizës përkatëse ligjore: Legjislacionin sekondar të aplikueshëm në BE, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, Ligjin për Mbikëqyrje Elektronike dhe Ligjin për Komunikime Elektronike. Pjesa e dytë i dedikohet çështjeve të lirisë së fjalës dhe të shtypit dhe analizon ligjet e mëposhtme themelore: Ligjin për Fshehtësinë e Burimeve, Ligjin Civil për Shpifje dhe Fyerje, Ligjin për Mbrojtjen e Zbuluesve (Whistleblowers), Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kodin e Medias së Shkruar.

Ky publikim është prodhuar me përkrahje të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e LENS dhe nuk mundet në asnjë mënyrë të merret si pikëpamje e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

HYRJE	4
KORNIZA LIGJORE – PRIVATËSIA	4
Bashkimi Evropian dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale	5
Legjislatura vendore	8
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	8
Kodi Penal	11
Kodi i Procedurës Penale	13
Ligji për qasje në dokumente publike	17
Ligji për Telekomunikime (Komunikimet Elektronike)	20
Ligji për përgjimet elektronike (përgjimin e komunikimeve elektronike)	22
KORNIZA LEGJISLATIVE - LIRIA E SHPREHJES DHE MEDIAVE.....	24
Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë	25
Ligji për mbrojtjen e informatorit	26
Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes	27
Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave	28
Kodi i Mediave të Shkruara	29
Qasja e palëve të interesit	30
Përdhunimi i privatësisë vs liria e shprehjes – 3 dështimet e kombinimit:	34
Rasti i Hamdi Sopës	34
Dënimi i parë me burgim të përjetshëm	34
Rasti i Albulena Haxhiut	35
REKOMANDIME	37

HYRJE

Ky punim ka për qëllim të mbledh kornizën ligjore si të mbrojtjes së privatësisë ashtu edhe të lirisë së shprehjes. Përderisa këto kryesisht shihen si koncepte të ndryshme, në të vërtetë ato janë dy anë të së njëjtës medalje. E megjithatë, të dy këto fusha shfaqin karakteristika të veçanta, posaçërisht sa i përket kodifikimit, e që e arsyeton trajtimin ndarazi në këtë punim.

Duke u bazuar në këtë, në pjesën e parë e cila fokusohet tek privatësia, ky punim kryesisht do të adresoj ligjet në vijim si qendër të vëmendjes të kornizës relevante ligjore: Ligjet dytësore të aplikueshme të Bashkimit Evropian, Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, Ligji mbi Qasjen në Dokumente Publike, Ligji mbi Vëzhgimet Elektronike dhe Ligji mbi Komunikimet Elektronike.

Pjesa e dytë do t'i dedikohet çështjeve të lirisë së shprehjes dhe shtypit dhe t'i analizoj ligjet thelbësore në vijim: Ligji mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji Civil Kundër Shpifjen dhe Fyerjes, Ligji mbi Mbrojtjen e Informatorit, Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.

Përderisa çështja e privatësisë është çështje mjaft komplekse që shkon përtej perspektivës ligjore, në dimensionet kulturore, sociale, dhe politike, në këtë punim do të rishikohet dhe debatohet vetëm perspektiva ligjore, me një pjesë që e bën një vështrim më të afërt të qasjes së palëve të interesit, duke përfshirë aspektin e mundësisë së qasjes së palëve në legjislacion.

KORNIZA LIGJORE – PRIVATËSIA

Në nivelin kombëtar në Kosovë, që nga viti 2010, ligji kryesor që merret me mbrojtjen të dhënave personale të qytetarëve, rrjedhimisht edhe privatësinë, është Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Megjithatë, është një numër ligjesh dhe rregulloresh, të cilët në një far mase e menaxhojnë të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e saj. Pasi që pa marrë parasysh që Kosova nuk është anëtare e BE-së të gjitha këto ligje rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, burimet përkatëse të ligjeve përbëjnë themelin e ligjeve në Kosovë andaj analiza jonë do të adresoj fillimisht kornizën mbi mbrojtjen e të dhënave të BE-së para se të ekzaminoj kornizën legjislative në vend.

BASHKIMI EVROPIAN DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Bashkimi Evropian ka shënuar zanafillën e mbrojtjes së kodifikuar të të dhënave personale përmes dispozitave ligjore të Direktivës 95/46 EC, e cila shërbente njëkohësisht edhe si bazë për harmonizimin dhe ndërtimin e ligjeve të shteteve anëtare. Ajo mund të konsiderohet akti më i rëndësishëm ligjor në mesin e bazës së larmishme ligjore që ofrohet nga BE-ja të cilat kanë të bëjnë me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave. Kjo direktivë, e hyrë në fuqi më 24 Tetor 1995, ofron një kornizë rregulluese nëpërmjet së cilës mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik, veçanërisht e drejta për privatësi në lidhje me përpunimin e të dhënave personale¹. Përveç kësaj, ky ligj i nxit shtetet anëtare që të themelojnë institucione të pavarura që mbikëqyrin përpunimin e të dhënave personale, si dhe sigurimin e qarkullimit të lirë të të dhënave ndërmjet shteteve anëtare.

Një burim i rëndësishëm i ligjit në këtë kontekst është Neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili i garanton gjithsecilit të drejtën për privatësi, pa ndërhyrje nga autoritetet përveç rasteve të justifikuara përfundimisht të cilat paraqiten në Nenin 8.2 (dispozitë kjo e përdorur si themel për Nenin 28 i LMDHP-së).

Megjithatë, Direktiva 95/46 EC është zëvendësuar rishtazi me amendamente dhe reforma, më të rëndësishmet nga të cilat janë Rregulla e Përgjithshme mbi Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 (RPMDH) dhe Udhëzimi 2016/680 për mbrojtjen e të dhënave sektorin e gjyqësisë dhe policisë, të cilat vazhdojnë të promovojnë dhe forcojnë kontrollin e subjekteve mbi privatësinë e të dhënave të tyre. Krahas zhvillimit të hovshëm teknologjik të viteve të fundit, lindi nevoja e domosdoshme për plotësimin dhe reformimin e rregullave aktuale në mënyrë që të reflektohen proporcionalisht me problemet të cilat janë shfaqur ose theksuar si rezultat i teknologjisë. Në këtë drejtim, në Janar 2012, Komisioni Evropian propozoi reformimin e rregullave evropiane mbi mbrojtjen e të dhënave, qasje kjo që më pastaj u formësua në një rregullore dhe një direktivë të përgjithshme mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Të dy këto akte ligjore kanë për qëllim t'ua kthejnë kontrollin e të dhënave personale subjekteve të tyre. Përderisa Rregullorja e re ka hyrë në fuqi më 24 Maj 2016 dhe do gjejë zbatim duke nisur nga viti 2018, Direktiva ka hyrë në fuqi më 5 Maj 2016 me një afat 2 vjeçar brenda të cilit shtetet anëtare duhet ta inkorporojnë në ligjin vendor². Që të dyja shfuqizojnë ligjet paraprake dhe vazhdojnë promovimin e përpunimit të të dhënave në mënyrë të ligjshme, të paanshme dhe transparente, pa tejkalar qëllimet për të cilat realizohen, duke i siguruar ato nga qasje të paautorizuara apo joligjore. Rregullat e reformuara vazhdojnë të ndërtohen mbi themelin e vënë nga Direktiva 95/46/EC dhe të plotësojnë ato hapësira të cilat paraprakisht krijonin hapësirë për dallime ndërmjet shteteve anëtare. Si të tilla, ato i shërbejnë qëllimit të harmonizimit të ligjeve vendore ashtu që personat fizik të gëzojnë të njëjtin nivel të të drejtave dhe të mbrojtjes në tërë Bashkimin Evropian. Megjithatë, shtetet anëtare lejohen që të

¹ Neni 1, 95/46/EC

² Neni 5, Rregulli 2016/679; Article 4, Udhëzimi 2016/680

vazhdojnë lëshojnë ligje bë mënyrë që të sigurojnë mbrojtje edhe më të lartë sesa ajo që parashihet në rregullat e reja. Krahas përmirësimeve të provizioneve ekzistuese, reforma gjithashtu sjellë rregulla krejtësisht të reja për të forcuar edhe më tej kontrollin e subjektit mbi të dhënat e veta personale.

Në lidhje me fushën materiale të zbatimit, RPMDH-ja e re dhe Udhëzimi 2016/680 vlen për përpunimin e të dhënave personale në tërësi ose pjesërisht në mënyrë automatike si dhe të përpunimit me mënyra tjera përpos atyre automatike të të dhënave personale të cilat formojnë pjesë të një sistemi të renditjes/ruajtjes ose kanë për qëllim të formojnë pjesë të një sistemi të renditjes/ruajtjes³.

Rëndësia praktike e këtyre provizioneve është më e madhe se kurrë më parë dhe është vazhdimisht në rritje. Sipas Eurobarometrit Special 431 mbi Mbrojtjen e të Dhënave nga viti 2015, më shumë se 6 nga 10 evropianë nuk iu besojnë kompanive telefonike dhe shërbimeve të internetit. Ata mendojnë se u mungon kontrolli i plotë mbi të dhënat personale, gjë që çoi drejt rregullit të ri të ashtuquajtur “e drejta për t’u harruar”. Sipas këtij rregulli, nëse një individ nuk pranon vazhdimin e përpunimit të të dhënave të tij, ato të dhëna duhet të fshihen për sa kohë që nuk ka bazë ligjore për mbajtjen e tyre. Kjo është realizuar si mënyrë e mbrojtjes së privatësisë së individit, jo si mënyrë e fshirjes së ngjarjeve të mëparshme apo për të kufizuar lirinë e shtypit. Me fjalë të tjera, individit që ka zgjedhur të fusë të dhëna në rrjete sociale, në momentin që dëshiron të mos jetë më i përfshirë në atë rrjet, do të ketë mundësinë që me fshirjen e llogarisë t’i fshihen në mënyrë të përhershme të gjitha të dhënat e lidhura me të. Megjithatë, kjo nuk është një e drejtë absolute dhe ekzistojnë kufizime që lidhen me ngjarjet e mëparshme relevante si dhe lirinë e shprehjes. Në lidhje me këtë, një politikan mundet, për shembull, jo vetëm të kërkojë që thëniet e tij të shlyhen nga rrjeti, në mënyrë që të mos komprometohet funksionimi i gazetave online ose portaleve tjera informative.

Për më tepër, 71% e evropianeve shprehen se nuk kanë zgjedhje tjetër përveç ofrimit të të dhënave të tyre si rezultat i shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve. Andaj, është paraparë që të implementohet mbrojtje e të dhënave në të gjitha produktet dhe shërbimet, si rrjetet sociale, telefonat e mençur, aplikacionet për telefon e të tjera. Kjo mbrojtje do të jetë e paracaktuar dhe do të vlejë pa përjashtime qysh në fazat e hershme të zhvillimit të tyre ashtu që privatësia e individëve të jetë normë e përgjithshme.

Eurobarometri po ashtu thekson se gjysma e evropianeve janë të shqetësuar për keqpërdorimin e të dhënave të tyre, dhe gati të gjithë kërkojnë të informohen në rast të humbjes apo vjedhjes së të dhënave të tyre. Si rrjedhojë, tashmë parashihet që në rast të shkeljeve apo qasjeve të paautorizuara që paraqesin rrezikshmëri të lartë të keqpërdorimit të të dhënave, kompanitë dhe organizatat që ofrojnë këto produkte dhe shërbime janë të detyruara

³ Neni 2.1 Regulation 2016/679 (see also Article 2.2 of Directive 2016/680 with the restriction to processing by specific competent authorities in 2.1).

që të njoftojnë autoritetin mbikëqyrës kombëtar. Në qoftë se ato nuk i respektojnë këto detyrime, atëherë autoritetet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave mund t'i dënojnë deri në 4% të fitimit vjetor. Megjithatë, vetëm 1/3 e evropianeve janë në dijeni për ekzistencën e një autoriteti kombëtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave të tyre, andaj vetëdijesimi vazhdon të jetë çështje problematike e gjithë-shtrirë në mbarë Evropën.

Përderisa siç shihet, Bashkimi Evropian ka zhvilluar një sërë ligjesh të cilat kanë shtruar rrugën për legjislacionin në Kosovë, pjesa tjetër e punimit do të pasqyrojë kornizën legjislative në vend – duke përfshirë këtu së pari Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale si dhe Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale – e më pas tërësinë e ligjeve të përmendura në fillim. Duhet pasur parasysh megjithatë që në këtë pjesë nuk është bërë analizimi i detajuar i kodeve dhe ligjeve por vetëm pasqyrimi i tyre në kontekstin e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale – si dhe lirisë së shprehjes dhe mediave.

Shkurtimisht:

1. Udhëzimi 95/46 ishte akti ligjor kryesor i BE-së në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe shërbeu si bazë për të harmonizuar ligjet përkatëse të vendeve anëtare të BE-së.
2. Ky udhëzim është zëvendësuar më Rregulloren 2016/679 dhe Udhëzimi 2016/680, i cili vazhdon të promovoj dhe forcoj kontrollin e subjektit të të dhënave mbi të dhënat e tyre personale.

LEGJISLATURA VENDORE

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i hyrë në fuqi më 15 Qershor 2010, shfuqizon dhe zëvendëson pjesën shtatë të Ligjit nr. 02/L-23 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike mbi përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e fshehtësisë së tyre⁴. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë “të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat” mbi mbrojtjen e privatësisë në formë të të dhënave personale, krahas themelimit të institucionit mbikëqyrës, konkretisht, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁵. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale qëndron përkitazi me Nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës e cila i garanton gjithsecilit të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Në të kundërt, në rast të përpunimit të tyre, kjo kryhet sipas ligjit. Si i tillë, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton paanshmërinë e mbledhjes së të dhënave personale si dhe ndalon tejkalinin e shfrytëzimit të tyre përtej qëllimeve të caktuara paraprakisht, me përjashtim të rasteve kur ligji e parasheh ndryshe⁶. Përpunimi i të dhënave, i përcaktuar sipas këtij ligji bëhet kryesisht me dhënie e pëlqimit nga subjekti, për sa kohë që vepron në interes të tij dhe të obligimeve ligjore të ndërmarra nga subjekti, kur vetë subjekti i publikon pa i kufizuar dhe kur bëhet për arsye të interesit thelbësor publik⁷.

Megjithatë, mbledhja e të dhënave mund të mos vijë drejtpërdrejt nga vetë subjekti. Në raste të tilla, kur subjekti i të dhënave nuk është në dijeni për mbledhjen e tyre, kontrolluesi i të dhënave është i detyruar që ndër të tjera të njoftojë subjektin mbi origjinën e të dhënave, qëllimin e përpunimit si dhe t’i ofrojë informacione mbi të drejtën e qasjes dhe përpunimit të të dhënave.⁸ Në të njëjtën kohë, këto informacione mund të sigurohen edhe në bazë të Nenit 22 i cili i garanton çdo subjekti të dhënat e të cilat janë përpunuar të konsultojë katalogun e dosjeve të të dhënave mbi të. Krahas të dhënave të lartpërmendura, përfshihen marrësit e të dhënave, koha, baza ligjore si dhe procedurat teknike prapa vendimmarrjes.

Kërkesa për t’i siguruar këto informacione mund të parashtrohet gojarisht, me shkrim apo në mënyrë elektronike. Pasi që kërkesa të pranohet nga kontrolluesi i të dhënave, brenda një afati 15 ditor⁹, duhet të konfirmojë atë ose në të kundërt të ofrojë një shkresë mbi pamundësinë e realizimit të saj. Për më tepër, subjekti ka të drejtë që të parashtrijë kërkesë me ç’rast “kontrolluesi i të dhënave duhet të shtojë, të korrigojë, të blloktojë, shkatërrojë, fshijë ose asgjësojë të dhënat personale për të cilat subjekti i të dhënave vërteton se janë jo të plota, jo të sakta ose jo të

⁴ Article 95, LPPD

⁵ Article 1, LPPD

⁶ Articles 3.1;3.2;3.3 LPPD

⁷ Article 6.1 LPPD

⁸ Neni 10.3, LMDHP

⁹ Article 23 LPPD

përditësuar, apo nëse janë grumbulluar ose përpunuar në kundërshtim me ligjin". Procedura dhe afati kohor qëndrojnë të njëjtë sikurse për kërkesat e qasjes në informacione, pra kërkesat apo kundërshtimet shqyrtohen brenda 15 ditësh, të cilat në rast refuzimi pranojnë përgjigje me shkrim.

Në të kundërt, nëse kontrolluesi i të dhënave nuk vepron në pajtueshmëri me dispozitat procedurale mbi këto kërkesa, atëherë subjekti i të dhënave mund t'i drejtohet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹⁰. Në raste të shkeljes së të drejtave, ligji i mundëson gjithë-secilit që ankesën ta parashtrojë gojarisht, në formë të shkruar, apo në mënyrë elektronike, me ç' rast Agjencia e njofton subjektin mbi vendimin në mënyrë të menjëhershme¹¹.

Po qe se i shkelen të drejtat e garantuara sipas këtij ligji, subjekti mund të kërkojë mbrojtje ligjore e cila ka kohëzgjatje të njëjtë me shkeljen. Nëse shkelja pushon dhe subjektin nuk i është dhënë mbrojtje tjetër ligjore, ai mund të paraqesë padi në gjykatën përkatëse për të vërtetuar ekzistencën e shkeljes¹².

Ekzistojnë përjashtime kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj për shkak të sigurisë e mbrojtjes kombëtare, sigurisë publike, proceseve të ndjekjes penale apo mbrojtjes së subjektit të të dhënave apo të të drejtave dhe lirive të personave tjerë. Këto masa qëndrojnë të vlefshme deri në realizimin e qëllimit për të cilin janë ngritur¹³.

ORGANI KRYESOR: Në kuadër të LMDHP-së ishte i paraparë edhe themelimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Statusi i saj rregullohet sipas Nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas të cilit përkufizohet si "agjenci e pavarur, e ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave". Sa i përket rregullimit organizativ, Agjencia udhëhiqet nga Këshilli i cili vepron në mënyrë të pavarur, përbërë nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i cili kryeson dhe përfaqëson Agjencinë, si dhe nga Mbikëqyrësi Kryesor. Veprimtaria e saj përfshin këshillimin e organeve publike dhe private mbi mbrojtjen e të dhënave personale, vendimmarrjen mbi ankesat e subjekteve, ushtrimin e inspektimeve dhe kontrolleve, informimin e publikut për zhvillimet në mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave¹⁴.

Si e tillë, Agjencia ka marrëdhënie të ndërsjellë me Kuvendin e Kosovës, ku ky i fundit duhet ta informojë Agjencinë mbi masa të reja legjislative e administrative përpara miratimit të tyre¹⁵. Në anën tjetër, përveç këshillë-dhënies, Agjencia duhet t'i dorëzojë Kuvendit raportin vjetor i cili duhet të publikohet më së largu më 31 Mars të vitit pasardhës¹⁶.

¹⁰ Article 24.1; 25.1; 25.2; 25.3 LPPD

¹¹ Article 42 LPPD

¹² Article 26 LPPD

¹³ Article 28 LPPD

¹⁴ Article 29 LDDP

¹⁵ Article 39 LDDP

¹⁶ Article 44 LDDP

Së dyti, Agjencia gjithashtu ka mundësi që me vetiniciative të nisë inspektime dhe kontrole të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat mbi mbrojtjen e të dhënave¹⁷. Këto procese kryhen nga Mbikëqyrësit të cilët janë të kufizuar të veprojnë brenda kompetencave të dhëna nga ligji. Mbikëqyrësit përveçse janë të detyruar që të identifikohen, gjë që mund të realizohet nëpërmjet kartave identifikuese të lëshuara nga Qeveria e Kosovës¹⁸, po ashtu duhet të respektojnë fshehtësinë e subjekteve si gjatë këtij procesi, ashtu dhe pas përfundimit të tij¹⁹.

Parë nga një këndvështrim ligjor, Agjencia ligjërisht ka një mbështetje të avancuar për sa i përket organizimit dhe funksionimit në mbrojtjen e të dhënave. Mirëpo pavarësisht kësaj, ajo vazhdon të ballafaqohet me probleme të shumta ndër të cilat vazhdon të jetë sfidues niveli i vetëdijesimit të opinionit publik²⁰. Problem tjetër paraqesin implementimi i plotë i ligjit, kapacitetet e vetë Agjencisë dhe pengesat në aftësimin e plotë të punonjësve të saj.

Në kuadër të aktivitetit të Agjencisë për të përmirësuar gjendjen në këtë drejtim, gjatë vitit 2015 ka shtuar praninë e saj në rrjete sociale, si dhe ka organizuar “Javën e Privatësisë” në komunat më të mëdha të vendit ku janë shpërndarë fletëpalosje, broshura dhe informacione të tjera nëpërmjet stendave të ngritura për këtë qëllim²¹. Po ashtu janë publikuar broshura mbi aftësimin e personelit në nivel lokal dhe qendror, siç janë Doracaku mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Zyrtarët Komunalë, si dhe Plani i Përgjithshëm mbi Trajnimin e Zyrtarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale krahas një sërë trajnimesh të mbajtura gjatë vitit²². Sa i përket numrit të zyrtarëve, Agjencia funksionon me vetëm 18 sosh nga 37 sa janë të paraparë gjithsej. Pasi që numri i ulët paraqet pengesë për funksionalizimin e plotë të Agjencisë, kërkesë e saj për vitin 2015 ishte dhe shtimi i këtij numri me 9 zyrtarë të tjerë, gjë e cila vazhdon të jetë e përpunuar.

Shkurtimisht:

1. Në kuadër të këtij ligji parashihet një organ – Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale – kompetencat e të cilës janë të shpjeguara më sipër
2. Qytetari që ka dyshime në lidhje me ndonjë çështje të privatësisë mund të drejtojë kërkesën për opinion sqarues te kjo Agjenci
3. Përgjigjja nga Agjencia nuk përjashton mundësinë e drejtimit në Gjykatë

¹⁷ Article 46 LDDP

¹⁸ Article 47 LDDP

¹⁹ Article 50 LDDP

²⁰ Florian Qehaja, , Material diskutimi për mbrojtjen e të dhënave personale, fq. 1

²¹ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Raporti Vjetor i Punës (2015), fq. 34-35

²² Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Raporti Vjetor i Punës (2015), fq. 5; 15-16

Kodi Penal

Në Kodin Penal të Kosovës të hyrë në fuqi në Janar të vitit 2013²³ përmendet tre herë fjala privatësi. Një herë në Nenin 70, par 5 ku thuhet shprehimisht:

Publikimi i aktgjyimit nuk urdhërohet nëse publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë

dhe dy herë në Nenin 205 ku flitet për fotografimin dhe incizimin e paautorizuar. Në këtë pjesë thuhet shprehimisht:

Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thellësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Megjithatë, duhet theksuar se roli primar i Kodit Penal të Kosovës është përcaktimi i veprave penale – dhe si pasojë e kësaj ka shumë pak detaje në lidhje me çfarëdo procedure – jo vetëm për privatësinë. Procedurat i përcakton Kodi i Procedurës Penale siç edhe do të shpjegohet në pjesën e mëposhtme të këtij punimi.

Për dallim prej Kodit Penal të vjetër – Kodi i ri Penal që ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2013 - përcakton si vepër penale fotografimin dhe incizimin e paautorizuar jo vetëm në hapësira personale por edhe në ato vende ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi.

Marrë parasysh këtë ndryshim – në tërësinë e tij Kodi i ri Penal ofron mbulesë të mirë ligjore për privatësinë.

Tutje, sa i përket lirisë së shprehjes dhe mediave Kodi Penal përmban një kapitull të tërë ku përcakton dispozitat e posaçme mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të mediave. Kodi përmban 4 nene gjithsej (nenet 37, 38, 39 dhe 40) në lidhje me përgjegjësinë penale të personave fizik dhe atyre juridik (3 prej të cilave janë shfuqizuar me Ligjin 04/L-129²⁴.

Neni 37 përcaktonte hierarkinë e përgjegjësisë penale për ndonjë vepër penale të kryer përmes mediave (fillimisht autori, pastaj kryeredaktori, më pas botuesi e në fund prodhuesi).

Neni 38 lidhej direkt me Ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe përcaktonte se media nuk është penalisht përgjegjëse nëse refuzojnë të tregojnë burimin e informatës – përveç në rastin kur gjykata konsideron se zbulimi i

²³ <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

²⁴ ²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2852>

informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi. Neni 39 ndërkaq thjeshtë përcaktonte zbatueshmërinë e dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale.

Të tria këto nene janë shfuqizuar pas bujës së madhe që mediat dhe shoqëria civile kanë bërë në lidhje me de-kriminalizimin e këtyre veprave penale. Si pasojë e kësaj tani ka mbetur vetëm neni 40 i cili përcakton përgjegjësinë penale të personave juridik. Ky nen shprehimisht përcakton se:

Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer vepër penale duke vepruar në emër të personit juridik brenda autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të dobisë apo ka shkaktuar dëm për atë person juridik. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikën e afarizmit ose me urdhrat e personit juridik²⁵.

Personi juridik po ashtu është përgjegjës për veprën penale në rastin kur personi përgjegjës që ka kryer vepër penale nuk dënohet për atë vepër penale, si dhe përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.

Lënia e këtij neni dhe heqja e tre të tjerëve është interesante sepse nuk ka konsistencë në përgjegjësinë penale. Kodi lë penalisht përgjegjës subjektet juridike por heq përgjegjësinë penale nga subjektet fizike – nga përgjegjësia e të cilëve realisht rrjedh edhe përgjegjësia penale e personave juridik.

Me aq sa u tha më sipër vijmë në përfundim se Kodi Penal ka mbulesë të mjaftueshme dhe të mirë të të dy çështjeve – asaj të privatësisë si dhe lirisë së shprehjes dhe mediave. Duhet përmendur dhe kujtuar se Kodi nuk përcakton natyrisht shpifjen dhe fyerjen meqenëse këto të dyja janë vepra të cilat tashmë janë civile dhe jo penale dhe si të tilla rregullohen me Ligjin Civil për Shpifjen dhe Fyerjen (që do të adresohet më poshtë).

²⁵ Neni 40 - KPK

Kodi i Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës i cili gjithashtu ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2013²⁶ parasheh privatësinë si koncept në Nenin 19, par. 1.11²⁷. Ky përcaktim është me shumë rëndësi sepse përcakton saktë bazën se kur mund të lejohet ndërhyrja e qeverisë në privatësinë e një personi. Më tej, tek seksioni i marrjes së informatave, tek Neni 84 që parasheh masat e marra para fillimit të procedurës penale, në par. 5 përcaktohet shprehimisht:

Nëse masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni prokurori i shtetit ndërmerr masa të arsyeshme për ruajtjen e privatësisë së personave që nuk janë të përfshirë në vepër penale.

Tutje, tek analizat psikologjike përcaktohet se personi i cili është vlerësuar mund të kundërshtojë thirrjen para gjyqtarit të procedurës paraprake nëse ka shqetësime të privatësisë që nuk tejkalojnë rëndësinë e procedurës penale²⁸.

Mirëpo, përveç në formë të drejtpërdrejtë – KPP edhe në mënyrë indirekte dhe shumë të tërthortë merret me privatësinë. P.sh. në nenin 22 par. 1, pikën 64 – KPP përcakton si krim të rëndë cenimin e fshehtësisë së votimit. Më pas, ky Kod përcakton se Gjykata ka të drejtë të mbaj të dhënat edhe pa pëlqimin e palës përkatëse – porse nuk guxon t'i nxjerrë ato dhe duhet të mbrojë fshehtësinë e këtyre të dhënave²⁹.

KPP gjithashtu përcakton se policia, prokurori i shtetit dhe organet tjera publike detyrohen të procedojnë me kujdes në mbledhjen ose në sigurimin e të dhënave, duke pasur kujdes që të mos cenohet dinjiteti dhe reputacioni i personit të cilit i referohen të dhënat e tilla³⁰.

Ndërkaq është e natyrshme të përcaktohet e drejta e hetimit të fshehtë - njësoj sikur përcaktohet në kodet e tjera të vendeve në sistemin kontinental. Porse sidoqoftë hetimi i fshehtë i përcaktuar në nenin 88 ka edhe rregulla brenda të cilit funksionon. P.sh. është neni 96 që përcakton se *të dhënat personale të marra me anë të masës e cila nuk është më e nevojshme për qëllimin e ndjekjes penale ose të një rishqyrtimi nga gjykata e masës fshihen pa ndonjë vonesë. Arsyet e shtyrjes duhet të dokumentohen. Përderisa fshirja e të dhënave është shlyer thjesht për qëllimet e rishikimit të masës nga ana e gjykatës, shënimet nuk do të përdoren për qëllime të tjera pa pëlqimin e personit në fjalë; qasja në të dhëna duhet të kufizohet në mënyrën e duhur. Më tej prokurori shtetëror duhet ta njoftojë me*

²⁶ http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Kodi_i_procedures_penale.pdf

²⁷ 1.11. Gjasa reale - baza për urdhër për kontroll ose për të justifikuar ndërhyrjen e qeverisë në privatësinë e ndonjë personi. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale.

²⁸ Ibid

²⁹ Neni 67

³⁰ Neni 83

përpikëri me shkrim me anë të postës me rekomandë çdo person të ndonjë urdhri, se ai ose ajo ka qenë subjekt i atij urdhri dhe se ka të drejtë të parashtrojë padi në gjykatën kompetente brenda gjashtë (6) muajve nga data e njoftimit³¹.

Megjithatë, sa i përket pranueshmërisë së provave të marra përmes këtyre mënyrave – KPP përcakton se prova e cila është marrë nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, simulimi i blerjes së ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit ose hetimi i fshehtë lejohen vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar në nenin 88, paragrafi 3. i KPP. Ndërkaq par. 3 i Nenit 88 përcakton dy skenarë:

1. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.
2. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë veprë penale nga neni 90 i KPP.

Neni 90 ndërkaq përcakton më se 100 vepra penale të cilat mund të gjenden këtu: http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Kodi_i_procedures_penale.pdf

Personat që i janë nënshtruar urdhrin për hetim të fshehtë kanë të drejtë në ankesë dhe këtë e bëjnë para Panelit për Shqyrtimin e vëzhgimit dhe hetimit. Kur me rastin e vendosjes mbi ankesën, ky Panel konstaton se masa është e kundërligjshme ose urdhri për masën e tillë është i kundërligjshëm, mund të vendos që ose të pushojë urdhrin nëse ende është në fuqi ose të urdhërojë asgjësimin e materialeve të mbledhura ose të kompensojë personin ose personat që i janë nënshtruar urdhrin. Që do të thotë se ligjërisht personave u është lënë mundësia për kompensim.

Sa i përket lirisë së shprehjes dhe mediave - Kodi i Procedurës Penale natyrisht përcakton dispozita të veçanta. Ky Kod njeh mediat si institucion që mund të drejtojnë informacione tek prokurori i shtetit – përmes të cilave ky i fundit mund të nisë hetimin³².

Kodi i Procedurës Penale përcakton edhe një pjesë me shumë rëndësi që ka të bëjë me lirinë e shprehjes dhe mediave dhe reputacionin e personave të arrestuar por të cilët më pas shpallen të pafajshëm. Për këtë çështje – Kodi parasheh që kur rasti i dënimit të paarsyeshëm ose i arrestimit të pabazë të ndonjë personi është paraqitur në mjetet publike të informimit dhe me këtë është cenuar reputacioni i personit, gjykata, me kërkesën e tij, shpall njoftimin në gazetë

³¹ Neni 96

³² Neni 6 - KPP

ose në mjetin tjetër të informimit publik për vendimin nga i cili shihet qartë se dënimi ishte i paarsyeshëm ose arrestimi i pabazë. Kur rasti nuk është paraqitur në mjetet e informimit publik, me kërkesën e personit, njoftimi i tillë i dërgohet punëdhënësit të tij. Pas vdekjes së personit të dënuar, e drejta për paraqitjen e kësaj kërkesë i takon bashkëshortit të tij apo bashkëshortit jashtëmartesor, fëmijëve, prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij.

Marrë në konsideratë gjithë sa u tha më sipër, është qëndrimi ynë që Kodi i Procedurës Penale ofron siguri dhe mbrojtje të mjaftueshme për të dyja – privatësinë dhe lirinë e shprehjes dhe mediave në Kosovë.

Siç është argumentuar edhe shumë herë më përpara – është qëndrim i përgjithshëm që problemi nuk qëndron me kornizën legjislative – por me implementimin e saj në praktikë. Problemet në lidhje me implementimin kanë të bëjnë me numrin e madh të lëndëve, kapacitetet e ulëta për adresim të tyre, mos-trajnimi i duhur i kuadrove dhe çështja e privatësisë dhe lirisë së shprehjes e mediave si dukuri të reja pas periudhës së komunizmit nën regjimin ish-jugosllav.

ORGANET KRYESORE: Për sqarim më të duhur dhe duke qenë se Prokuroria dhe Gjykata janë adresat më të rëndësishme në lidhje me këto dy kode – duhet sqaruar si funksionojnë dhe si ndahen këto të fundit. Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore, dhe me qëllim të veprimeve më efikase të gjykatës përkatëse, brenda Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore mund të themelohen Departamente dhe Divizione.

Duke qenë se interesi jonë në lidhje me rastet e privatësisë dhe lirisë së shprehjes – ka nismën në Gjykata Themelore – duhet sqaruar se këto të fundit janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Shtatë (7) Gjykata Themelore themelohen si në vijim:

- a. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë themelohet për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Glllogovcit dhe të Graçanicës;
- b. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan themelohet për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Klllokotit dhe Vërbocit;
- c. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren themelohet për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës;
- d. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë themelohet për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit;
- e. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë themelohet për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës;

- f. Gjykata Themelore e Ferizajt me seli në Ferizaj themelohet për territorin e Komunës së Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit;
- g. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Ndërkaq sa i përket Prokurorisë së Shtetit – duhet sqaruar se çka nënkuptohet me këtë term. Prokurori i Shtetit nënkupton institucionin e pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç cekën me ligj dhe përfshinë si në vijim: prokuroritë themelore, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe cilado njësi tjetër organizative që mund të krijohet për të ushtruar funksione prokuroriale.

Prokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet dhe funksionon në përputhje me ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe organizohet në prokuroritë si në vijim:

- a. Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe nga Departamenti për Krime të Rënda.
- b. Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë;
- c. Prokuroria Speciale; dhe
- d. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Lëndët që në lidhje me privatësinë dhe lirinë e shprehjes bien nën kompetencën e Prokurorisë Themelore – në rast nevojë dhe si të tilla Prokuroritë Themelore janë të ndara dhe funksionojnë njësoj sikur Gjykatat (siç u shpjegua më lartë).

Shkurtimisht:

1. Organet kryesore ku qytetari duhet të drejtohet në lidhje me këto dy Kode – janë Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore (varësisht nga qyteti)
2. Kodi Penal përcakton vetëm llojet e veprave penale – duke përfshirë kështu edhe shkeljen e privatësisë si një prej tyre
3. Kodi i Procedurës Penale përcakton procedurën se si bëhet ndjekja e këtyre veprave penale
4. Shpifja dhe fyerja nuk janë vepra penale

Ligji për qasje në dokumente publike

Ligji nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike ka hyrë në fuqi më 10 dhjetor 2010 dhe përmban dispozita ligjore nëpërmjet të cilave rregullohet “e drejta e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”³³.

Ky ligj shfuqizon Ligjin nr. 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare; Udhëzimin administrativ nr. 3/2006 për zbatimin e ligjit për qasje në dokumente zyrtare; Udhëzimin Administrativ nr. 05/2006 për organizimin dhe funksionimin e Zyrave për pranimin e ankesave dhe kërkesave - Tryeza e Komunikimit me qytetarë. Udhëzimin Administrativ nr. 07/2008-MSHP për forcimin e transparencës dhe standardizimit të faqeve të internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë ligj që ka të bëjë me të drejtën e qasjen në dokumente zyrtare³⁴.

E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike, është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në praktikën e shoqërive demokratike, çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe kjo përfshinë edhe të drejtën për të kërkuar dhe për të marrë informata. E drejta e qasjes në dokumente është thelbësore në arritjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera, në sigurimin e demokracisë, si dhe në zhvillimin e vendit. Kjo është e drejtë e secilit, kjo është e rregulluar dhe e mbrojtur me konventa të shumta të të drejtave të njeriut. Më e rëndësishmja prej tyre konsiderohet Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, ku thuhet se: “Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes së mendimit; kjo e drejtë përfshin lirinë për të shprehur pikëpamjet e tij pa ndërhyrje dhe të kërkojë, marrë dhe japë informata dhe ide nëpërmes çfarëdo medie dhe pa marrë parasysh kufijtë”. Ndërsa Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton: “1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike” “2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

Transparenca maksimale dhe mbrojtja e privatësisë mbetet parimi themelor i legjislacionit për qasje në dokumente publike, sipas standardeve ndërkombëtare. Neni 4 i këtij ligji siguron qasje në dokumente publike, sipas të cilit të gjitha informacionet që mbahen nga institucionet, duhet të jenë publike, dhe duhet të jenë të qasshme për të gjithë, dhe kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm atëherë kur ndonjë informacion bën pjesë në grupin e informatave të përjashtuara me Ligj. Këto përjashtime parashihen shprehimisht në Nenin 12 dhe janë ato dokumente të cilat mund të refuzohen për qëllime të mbrojtjes së:

1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;

³³ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Raporti Vjetor i Punës (2015), fq. 34-35

³⁴ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Raporti Vjetor i Punës (2015), fq. 5; 15-16

- 1.2. sigurisë publike;
- 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;
- 1.4. hulumtimeve disiplinore;
- 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;
- 1.6. privatësisë dhe interesave të tjera legjitime private;
- 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;
- 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
- 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
- 1.10. mjedisit, apo,
- 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje

Neni 5 i këtij ligji obligon të gjitha institucionet publike të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente. Bërja e kërkesës duhet të jetë e thjeshtë e shpejtë dhe e lirë, kërkesa për qasje në dokumente mund të refuzohet, mirëpo refuzimi duhet të arsyetohet³⁵. Neni 7 i këtij ligji tregon se nëse institucioni përkatës nuk siguron dokumentet publike të kërkuara dhe ka njohuri për institucionin tjetër, menjëherë ose më së voni pesë (5) ditë pune, nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim të kërkuarit, është i detyruar që kërkesën t’ia përcjellë organit gjegjës ose sektorit të tij, i cili e posedon, disponon ose e mbikëqyrë informatën. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm, kërkuari mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, të parashtojë kërkesën për rishqyrtim e çështjes, e cila duhet të shqyrtohet brenda shtatë (7) ditësh prej kohës së regjistrimit të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes³⁶. Mos përgjigja e institucionit publik ndaj kërkesës brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi³⁷.

Ky ligj ofron gjithashtu mundësinë e qasjes së drejtpërdrejte në dokumente publike në formë elektronike. Për më tepër ligji detyron institucionet publike që në formë elektronike përmes botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës t’i publikojnë të gjitha dokumentet e publikueshme të cilat ato i hartojnë, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Të gjitha institucionet përkatëse publike duhet të kenë një adresë e-mail në të cilën mund të adresohen qytetarët. Që të jetë sa më efikase ngarkohet një person të menaxhojë rregullisht të dhënat e pranuar. I njëjti mund të jetë përgjegjës për rifreskimin, sigurimin e qasjes dhe

³⁵ Neni 6, LQDP

³⁶ Neni 9, LQDP

³⁷ Neni 10, LQDP

besueshmërinë e informatave në ueb faqet e institucioneve publike. Neni 13 siguron mbrojtjen e të dhënave personale “Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, institucionet mund të lëshojnë të dhëna të tilla vetëm në bazë të pëlqimit të mëparshëm dhe të qartë të personit në fjalë.” Për të siguruar transparencë të plotë secili institucion publik obligohet të hartoj raport vjetor për vitin paraprak, ku përfshihet, numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve. Secili institucion publik, raportin vjetor për vitin paraprak, ia dërgon njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, më së largu deri në fund të muajit janar të vitit përkatës³⁸. Shikimi i dokumenteve zyrtare në objektet e institucionit publik është pa pagesë. Një tarifë mund t’i ngarkohet kërkuesit për kopje të dokumentit, e cila është e arsyeshme dhe kjo rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria e financave dhe janë unike për të gjitha institucionet publike. Të gjitha këto duhet të publikohen. Institucioni publik i cili në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, i pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave në qasje në dokumente publike dhe informata, dënohet me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri dhjetëmijë (10.000) Euro.

ORGANI KRYESOR: Ky ligj nuk parasheh një organ të veçantë por përcakton se të gjitha institucionet publike janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente. Si pasojë e kësaj të gjitha kërkesat për qasje në dokumente i drejtohen njësisë apo zyrtarit për komunikim me qytetarë të institucionit përkatës. Institucioni publik obligohet që brenda shtatë ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim.

Ndërkaq në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm, kërkuesi mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, të parashtrijë kërkesën për rishqyrtim të çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin. Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes duhet të shqyrtohet brenda shtatë (7) ditësh prej kohës së regjistrimit të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes.

Refuzimi i kërkesës së kërkuesit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuesit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, shkallës së dytë (varësisht nga cili institucion bëhet kërkesa) dhe Gjykatës Themelore.

³⁸ Neni 20 LQDP

Shkurtimisht:

1. Avokati i Popullit është shkalla e dytë që përcakton ankesat për refuzim të kërkesave për qasje në dokumente publike
2. Nëse një qytetari i intereson marrja e një dokumenti i cili nuk bie nën përjashtimet e nenit 12 të Ligjit – mjafton të dërgojë kërkesën në institucionin përkatës (me telefon, email apo postë)
3. Institucioni përkatës duhet përgjigjur brenda 7 ditësh në kërkesën fillestare

Pas marrjes së vendimit përfundimtar të institucionit (në rast të refuzimit) apo heshtjes administrative, qytetari ka të drejtë të nis' procedurën për konflikt administrativ brenda 30 ditëve prej marrjes së vendimit – në Gjykatën Themelore.

Ligji për Telekomunikime (Komunikimet Elektronike)

Ligji nr. 04/L-109 për komunikime elektronike ka hyrë në fuqi më 24 Nëntor 2012 me të cilin shfuqizohet Ligji nr. 2002/7 mbi Telekomunikacionin të datës 12.5.2003 si dhe Ligjin nr. 03/L-085 për ndryshimin e Ligjit për Telekomunikacion të datës 13.06.2008. “Ky ligj rregullon marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, shërbimet dhe lehtësimet shoqërore, përdorimin e resurseve të komunikimeve elektronike, si dhe marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me radio-pajisjet, pajisjet fundore dhe përputhshmërinë elektromagnetike, siguron nivel të barabartë të mbrojtjes së të drejtave për të dhënat personale, veçanërisht të drejtën e privatësisë së përpunimit të të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike”.

Çdo ndërmarrës ka të drejtë të ofrojë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, pa leje paraprake individuale nga institucionet shtetërore. Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave dhe e numeracionit bëhet në përputhje me dispozitat e Kreut VII dhe VIII të këtij ligji. Neni 85 i këtij ligji siguron që ofruesit e shërbimit të komunikimeve elektronike publike duhet të ndërmarrë masa adekuate teknike dhe organizative për ta mbrojtur sigurinë e shërbimeve. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të informojë para-paguesit për të drejtat për të vendosur për përfshirje ose mos-përfshirje të të dhënave personale në informatorët telefonik dhe për llojin e të dhënave për të cilat bëhet fjalë në këtë ligj, si dhe legjislacionit të BE-së për mbrojtje të të dhënave dhe privatësi në komunikime elektronike.

Objektivat e këtij ligji mbrojnë interesat e shfrytëzuesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike për t'i mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e tyre. Po ashtu kontrata e lidhur në mes të konsumatorëve dhe ndërmarrësve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike mund të përmbajë çfarëdo informacioni për kufizime që rrjetet dhe

shërbimet e komunikimeve elektronike ose të përdoren për aktivitete të jashtëligjshme apo për shpërndarje të përmbajtjeve të dëmshme, si dhe për mënyrat për t'u mbrojtur nga rreziqet për siguri personale, privatësinë dhe të dhënat personale.

ORGANET KRYESORE: Organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike janë Ministria përkatëse (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) dhe Autoriteti Rregullues i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Në kuadër të detyrave të tyre bëjnë pjesë: koordinimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe strategjive kombëtare të Qeverisë mbi komunikime elektronike, koordinimi dhe mbikëqyrja e zhvillimit të programeve të investimeve shtetërore në fushën e komunikimeve elektronike, vlerësimet ekonomike, financiare dhe teknike të programeve të tilla dhe ushtron kontroll mbi zbatimin e tyre.

Po ashtu, Autoriteti Rregullues i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje ARKEP) është autoriteti rregullator kombëtar në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare, i cili kryen detyrat e përcaktuara nga ky ligj dhe nga legjislacioni tjetër në fuqi, si dhe zbaton politikat dhe strategjitë kombëtare të sektorit të komunikimeve elektronike, të përcaktuara nga Ministria.

Në përfundim të çdo viti, ARKEP paraqet në Kuvend brenda gjashtë mujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit paraprak. Kompetencat e autoritetit ndër të tjera janë të publikojë çdo informacion të nevojshëm për zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues. Rregullat për publikimin e informacionit të tillë, duke përfshirë qëllimin e tij, përcaktohen nga Autoriteti, duke marrë parasysh normat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e informacionit të fshehtë, përfshirë sekretet shtetërore, të biznesit apo ato komerciale, apo informacionin privat në lidhje me një person fizik. Bashkëpunimi i autoriteteve brenda këtij ligji është shumë i rëndësishëm, Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale bashkëpunon me ARKEP-in në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Ndërkaq sa i përket ankesave – kjo mundësi parashihet vetëm për shfrytëzuesit fundorë. Këta të fundit janë shfrytëzues që nuk ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike publike, të disponueshme për publikun. Në rast të mosmarrëveshjeve në mes të ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shfrytëzuesit fundor, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet ARKEP-it për zgjidhje të mosmarrëveshjeve para se çështja të shkojë në procedurë gjyqësore. Shfrytëzuesi gjithashtu ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës direkt. ARKEP pas provimit për pajtim të palëve mund të marrë vendim – të cilin më pas shfrytëzuesi fundor mund ta apelojë në afat prej 30 ditësh në Gjykatën Themelore.

Shkurtimisht:

1. Organet kryesor në bazë të këtij ligji janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe ARKEP
2. Roli i këtyre organeve është më larg prej qytetarit: Ministria përcakton strategjinë dhe politikat ndërkafq ARKEP zbaton politikat dhe strategjitë kombëtare të sektorit të komunikimeve elektronike
3. E drejta e ankesës sipas këtij ligji parashihet vetëm për shfrytëzuesit fundor – jo edhe ata të thjeshtë

Ligji për përgjimet elektronike (përgjimin e komunikimeve elektronike)

Ligji nr. 05/L -030 për përgjimin e komunikimeve elektronike ka hyrë në fuqi më 28 Korrik 2015. Ky ligj rregullon procedurat dhe kushtet mbi përgjimin e komunikimeve elektronike që realizohen për nevoja të procedurës penale nga institucionet shtetërore të themeluara me ligj, po ashtu ky ligj përcakton detyrimet dhe autorizimet e institucioneve shtetërore të themeluara me ligj për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin e përgjimit të ligjshëm, si dhe kontrollin në zbatimin e procedurave të përgjimit. Ky thirret në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohur dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (përfshirë edhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

Në bazë të ligjit, përgjim i ligjshëm konsiderohet vetëm ai për të cilin është lëshuar urdhër i ligjshëm nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin. Përgjimet për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj realizohen në përputhje me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, pas lëshimit të Urdhrit gjyqësor të gjyqtarit të Gjykatës Supreme, në përputhje me Nenin 4 mbi parimet themelore të përgjimit të përcaktuara me këtë ligj. Në rastin e përgjimit, gjykata kompetente merr përsipër detyrimin për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të personave ndaj të cilëve do të bëhet përgjimi, dhe po ashtu është e obliguar të mbrojë të drejtat e gazetarëve për ruajtjen e burimeve të informacionit dhe për mos zbulimin e burimit të mbrojtur të informatës të përcaktuar me ligjet në fuqi dhe me Konventat ndërkombëtare.

Në bazë të ligjit, persona të caktuar mund të përgjohen në dy raste, për nevoja të procedurës penale (ku të drejtë për të parashtruar kërkesë ka vetëm Prokurori i shtetit) dhe për nevoja të sigurisë nacionale. Në bazë të Nenit 6, një përgjim i ligjshëm konsiderohet ai i cili kalon në tri faza: parashtrimi i kërkesës për përgjim nga institucioni i autorizuar me ligj, shqyrtimi, miratimi dhe paraqitja e kërkesës për përgjim dhe urdhri gjyqësor për përgjim, përndryshe nuk mund të konsiderohet si i tillë. Zyrtari i autorizuar për përgjim ka për obligim që të sigurojë se asnjë përgjim i ligjshëm nuk bëhet pa Urdhrin për përgjim të lëshuar nga gjykata relevante në përputhje me Nenin 11 të këtij ligji. Secili përgjim i ligjshëm i cili mundësohet duke respektuar parimin e fshehtësisë dhe procedurat e parapara me këtë ligj, duhet të ndodh në atë mënyrë që as caku i përgjimit e as ndonjë person tjetër i paautorizuar nuk guxon të jetë në

dijeni për përgjim, përveç nëse kjo është e kërkuar me ligj. Çdo e dhënë e mbledhur, e ruajtur apo e transmetuar në lidhje me një përgjim duhet të mbrohet në atë mënyrë që të parandalohet dhe të ndalohet përdorimi i paautorizuar ose i paligjshëm i një të dhëne të tillë, dhe do të trajtohet sipas standardeve të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

Çdo person i punësuar apo i kontraktuar nga organet përgjegjëse të përgjimeve, përfshirë këtu edhe të punësuarit të cilët trajtojnë ose mund të vihen në dijeni, duhet të ketë një verifikim sigurie të lëshuar nga AKI në përputhje me ligjin nr. 03/l-178, kjo vlen po ashtu për çdo gjë tjetër e cila hyn në punë gjatë përgjimit. Pas arritjes së qëllimit dhe detyrave të institucioneve të autorizuara dhe autoriteteve tjera relevante në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe fushëveprimet të tyre, të dhënat nga përgjimet duhet të shkatërrohen në përputhje me detyrimet e përcaktuara në KPPK dhe Ligjin për AKI-në.

Ndërkaq sa i përket ruajtjes së të dhënave, ligji përcakton se qasja në të dhënat e marra përmes përgjimit të ligjshëm do të kufizohet në mënyrë strikte vetëm me ata individë të cilët janë drejtpërdrejt të përfshirë në hetimin e çështjes me të cilën ndërlidhen të dhënat si dhe me individët të cilët janë të nevojshëm për zbatimin teknik të Urdhrit për përgjimin e ligjshëm. Vetëm të dhënat të cilat janë drejtpërdrejt të rëndësishme për hetimet zyrtare dhe hetimet në vazhdim e sipër mund të ruhen.

ORGANI KRYESOR: Përmes këtij ligji themelohet mekanizmi i Komisionarit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve të Komunikimeve (Komisionari). Ky organ është mekanizëm I vendosur në kuadër të strukturës institucionale të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe bën kontrollin vjetor të ligjshmërisë së përgjimeve të komunikimeve. Gjithashtu Komisionari i raporton KGJK-së dhe Prokurorit të Shtetit në baza vjetore për shkeljet e gjetura. (Më pas Prokurori i Shtetit ka të drejtë të nisë hetimet ex officio).

Komisionari si organ vepron me buxhet të veçantë brenda buxhetit vjetor operues të KGJK-së. Në krye të këtij organi qëndron Komisionari i cili ka mandate 4 vjeçar dhe emërohet nga KGJK. Mekanizmi i Komisionarit përveç identifikimit të shkeljeve bën edhe monitorimin e standardeve ligjore të vendimeve gjyqësore për përgjim të ligjshëm, verifikimin nëse personat e autorizuar në kuadër të institucioneve të autorizuara për përgjim të ligjshëm e kanë ushtruar një mandat të tillë dhe verifikimin e shkatërrimit të informacioneve të mbledhura nga procesi i përgjimit.

Është me shumë rëndësi të dihet që konkluzionet dhe shkeljet e mundshme të gjetura nga Komisionari nuk kanë efekt juridik në procedurën penale dhe vendimet e gjykatave kompetente.

Shkurtimisht:

1. Organi kryesor sipas këtij ligji është Komisionari
2. Të dhënat e tubuara gjatë përgjimit, kufizohen vetëm tek individët e përfshirë direkt në hetime
3. Ka vetëm dy përjashtime kur lejohet përgjimi: për nevoja të procedurës penale dhe për nevoja të sigurisë nacionale

PËRFUNDIME:

Marrë parasysh gjithë sa u tha më sipër në lidhje me kornizën legjislative të kategorisë së privatësisë vijmë në përfundim se kjo fushë është e përfshirë në legjislacionin vendor por inputin kryesor e ka marrë nga Direktivat e Bashkimit Evropian. Në ndërkohë, Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale ofrojnë mbulesë të privatësisë deri në një masë por është Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili shprehimisht e përcakton çështjen e privatësisë për se. Megjithatë ekzistojnë probleme të konsiderueshme në lidhje me bashkëveprimin e këtij ligji dhe ligjit për qasje në dokumente publike. Si pasojë e kësaj (dhe faktorëve të tjerë) të dy këto ligje janë në proces të amandamentimit.

KORNIZA LEGJISLATIVE - LIRIA E SHPREHJES DHE MEDIAVE

Përveç Kodeve të përmendura më sipër me pjesë të të cilave rregullohet liria e shprehjes dhe liria e mediave, më poshtë do të analizohen disa ligje dhe rregullore shtesë të cilat rregullojnë fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave të shkruara posaçërisht.

Si të tillë, janë Ligji mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji mbi Mbrojtjen e Informatorit, Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Kodi Etik i Mediave të Shkruara të Kosovës.

Deri më tani, me sa shihet, nuk ka pasur një diskutim substancial ose një analizë të ngjashme rreth lidhjes ndërmjet kategorive që janë temë e këtij punimi: privatësisë dhe lirisë së shprehjes dhe medias. Në një situatë ideale, liria e fjalës dhe e mediave duhet të jenë të lidhura ngushtë me privatësinë. Në Kosovë, në shumë raste, këto dy kategori nuk janë të ndërlidhura por e përjashtojnë njëra tjetrën, dhe ky fakt paraqet problem. Shpesh ky përjashtim vjen si rezultat i informimit jo të duhur në lidhje me kornizën ligjorë në vend. Prandaj, në këtë punim ne synojmë të shpjegojmë kornizën ligjore të të dy kategorive dhe ti analizojmë ndërlidhjet e tyre përmes teorisë dhe shembujve praktik.

Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Ky ligj ka hyrë në fuqi më 23 mars 2013 dhe është një prej ligjeve më të shkurta në vend. Ka vetëm 10 nene dhe në to përcakton rastet kur mediat kanë lirinë të mbrojnë burimet e tyre. Ligji është i zbatueshëm për të gjithë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias, që janë të angazhuar në mbledhjen, përgatitjen, dhe përhapjen e informacionit nëpërmjet medias, të cilët janë nën juridiksionin e Republikës së Kosovës e që nuk mund t'iu mohohet mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve të garantuara nga ky ligj, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë çështje të ndryshme të lirisë së medias.

Megjithatë ligji në fjalë duhet lexuar në linjë të drejtë me Kodin Penal dhe jo i ndarë nga ai. Kjo sepse edhe Kodi Penal parasheh çështjen e burimeve të gazetarisë.

Sidoqoftë, ligji ka një nen i cili është përjashtues. Neni 5 përcakton se realisht mund të ketë raste kur burimi duhet bërë i ditur:

Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të detyruar të zbulojnë identitetin e burimit të informacionit siç referohet në nenin 4 të këtij ligji, vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm nëse: zbulimi i identitetit të burimit të informacionit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë vdekjen të një ose më shumë personave.

Kjo do të thotë që ligji u mundëson mediave të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes edhe duke mbrojtur burimet e tyre anonime – përveç në rastet kur këto burime i duhen gjykatës për të parandaluar një kërcënim serioz dhe që nuk mund të sigurohet në asnjë mënyrë tjetër.

Sidoqoftë, pikërisht ky nen është njëri prej neneve që shfrytëzohet më së shumti nga sistemi për të pamundësuar mediave që të ruajnë informacionet e burimet e tyre.

Shkurtimisht:

1. Organi që ka të drejtën të kërkojë burimin nga gazetarët është Gjykata
2. Ligji u dedikohet gazetarëve andaj një qytetar nuk ka mundësi të jetë subjekt i tij
3. Zbulimi i identitetit të burimit të informacionit bëhet vetëm në rast të rrezikut serioz

Ligji për mbrojtjen e informatorit

Ky ligj ka hyrë në fuqi më 9 shtator 2011 dhe për momentin është në proces të amendamentimit. Sipas këtij ligji informator konsiderohet çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor.

Lidhshmëria e mediave, lirisë së shprehjes me këtë ligj është e madhe. Informatori ka të drejtën të dërgojë informacionin në institucionin publik siç përcaktohet në ligj – dhe media është një prej tyre. Megjithatë – informatori rezervon gjithmonë të drejtën të ruajë anonimitetin e tij.

Ky ligj ka probleme të shumta, duke nisur me emërtimin “informator” i cili në zhargonin që përdoret në gjuhën shqipe ka konotacion negativ, duke u nënkuptuar si “spion” apo “punonjës/e të shërbimeve sekrete” gjë e cila është e gabuar, e për të vazhduar me faktin se nuk krijon mekanizma përkatës për dërgimin e informacionit e as mekanizma që tregojnë se çka duhet të bëhet kur zyrtari dëshiron të lajmërojë eprorin e vet.

Ligji megjithatë përcakton shprehimisht institucionet tek të cilat informatori mund të drejtohet:

- a. Institucionet e larta të RKS (Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe Gjykata Kushtetuese)
- b. Autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale (Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykatat, Prokuroritë)
- c. Autoritetet e larta të administratës shtetërore (Qeveria, Kryeministri, Zëvendësministrat dhe ministrat)
- d. Organet qendrore të administratës shtetërore
- e. Organet lokale të administratës shtetërore
- f. Organet e pavarura të administratës shtetërore
- g. Institucionet e pavarura të parapara në Kapitullin XII të Kushtetutës³⁹

Siç vërehet edhe nga çka u tha më lartë – partitë politike nuk bëjnë pjesë në institucionet tek të cilat informatori mund të dërgojë informacionin që ka.

³⁹ Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, KQZ, BQK, Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Agjencitë e Pavarura

Shkurtimisht:

1. Pasi nuk janë caktuar organe kompetente për pranim të ankesave dhe mbrojtjes të qytetarëve/zyrtarëve që u zbulohet identiteti apo kur ndaj tyre merren masa diskriminuese, të dëmtuarit mund t'i drejtohen gjykatës.
2. Çdo person, qytetar apo i punësuar mund të informojë për ekzistimin e veprimeve kundërligjore
3. Nuk ekziston një organ i caktuar ku qytetari/punëtori mund të drejtohet për dhënie të informatës, kur eprori nuk ndërmerr asgjë edhe pasi ka marrë informatën.
4. Për punonjësit, ligjërisht njoftimi për afera të tilla referohet t'i bëhet eprorit të institucionit ku ata punojnë

Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes

Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 maj 2008 – menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe nuk është amendamentuar asnjëherë. Ligji është i lidhur ngushtë me lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave sepse përcakton se çka nënkuptohet me fyerje e çka me shpifje dhe deri ku mund të shtrihet liria e shprehjes.

Megjithatë përkundër këtyre përcaktimeve, ligji parasheh edhe rastet e përjashtimit nga përgjegjësia dhe kufijtë e përgjegjësisë në rastin kur kemi të bëjmë me interesin publik. Në këto raste ligji përcakton se i padituri mban përgjegjësinë për barrën e provës se ka vepruar në mënyrë të drejtë. Konstatimi nga gjykata se i padituri ka vepruar me përgjegjësi në publikimin e deklaratës, do të përjashtojë të paditurin nga çdo përgjegjësi, përveç nëse i padituri ka ditur se deklaratata ka qenë e rrejshme apo ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e deklaratës.

Ligji po ashtu përcakton se askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mire, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla (Neni 7).

Megjithatë janë gjithsej 12 raste kur çfarëdo deklarimi shpifës apo fyes nuk do të konsiderohet si i tillë. Disa ndër to janë rastet kur flitet brenda komisioneve qeveritare, në parlament apo para avokatit të popullit.

Ligji njuh edhe imunitetin e kushtëzuar dhe të drejtën për reagim si dhe urdhëresën që gjykata ta ndalojnë shpifjen dhe fyerjen përkohësisht duke propozuar heqjen e informacionit dhe kompensimin e palës së dëmtuar.

Shkurtimisht:

1. Organi kryesor sipas këtij ligji i cili vendos mbi paditë për shpifje dhe fyerje është Gjykata
2. Kërkesat për kompensim mund të paraqiten brenda 3 muajve nga dita kur personi është dëmtuar, duke mos kaluar në asnjë rast afatin 1 vjeçar
3. Nuk ka një afat të caktuar brenda të cilit Gjykata është e obliguar të trajtojë padinë

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave ka hyrë në fuqi më 5 Prill 2012 dhe kështu ka shfuqizuar Ligjin e vjetër për komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin⁴⁰. Ligji në fjalë ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale, audiovizuale që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale

Detyrë dhe përgjegjësi e KPM-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.

Në përgjithësi Ligji për KPM-në përcakton më në detaj kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të KPM dhe anëtarëve si dhe funksionet e zyrës ekzekutive. Më tej ky ligj shprehimisht rregullon edhe procedurën e licencimit të shërbyesve medial audiovizuel. Ligji normalisht përcakton edhe kategorinë e sanksioneve por pa përcaktuar shprehimisht asgjë në lidhje me privatësinë apo lirinë e shprehjes.

I vetmi nen që përmend dhe i referohet lirisë së shprehjes – është Neni 19 – par 1 që shprehimisht përcakton: *Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-se e në veçanti me Direktivën e Komisionit Evropian AVMS duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes.*

⁴⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809>

Marrë parasysh vet' natyrën e ligjit të KPM-së, ky i fundit nuk ka të bëjë shumë as me privatësinë e as me lirinë e shprehjes por thjeshtë me rregullimin e brendshëm të mediave audiovizuale – të cilat më pas rregullojnë çështjen e privatësisë dhe lirisë së shprehjes përmes dispozitave të ligjeve të përmendura më sipër.

Shkurtimisht:

1. Pas Komisionit si tërësi - organ kryesor sipas këtij ligji është Gjykata Themelore
2. Ligji në fjalë u dedikohet kryesisht mediave audiovizuale dhe si i tillë nuk lejon hapësirë të madhe interpretimi për qytetarët

Kodi i Mediave të Shkruara

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. KMSHK është themeluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë në shtator të vitit 2005, ndërsa Zyra e KMSHK-së aktivitetin e rregullt e ka filluar në dhjetor të vitit 2005⁴¹.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës për momentin i ka 17 anëtarë të rregullt, nga gazetatat, portalet dhe agjencitë e lajmeve. KMSHK ka tre anëtarë të pavarur, kryetarin dhe dy nënkryetarët. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e gazetave, portaleve dhe të agjencive të lajmeve.

Dokumentet në bazë të të cilave funksionon dhe vetë-rregullohet ky Këshill – janë Statuti dhe Kodi i Mediave. Megjithatë Statuti rregullon vetëm procedurën e mënyrës së vendosjes brenda Këshillit dhe detaje të Bordit – përderisa Kodi shërben si bazë për sistemin vetërregullues që profesionalisht dhe moralisht konsiderohet i obligueshëm për gazetarë, reporter, redaktorë, pronarë dhe botues të gazetave, portaleve dhe agjencive të lajmeve.

Ky Kod shprehimisht përcakton se gazetatat, portalet dhe agjencitë e lajmeve do t'u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përveç nëse ndërhyrje apo kërkime të tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik.

Ndërkaq sa i përket lirisë së shprehjes – e gjithë ekzistenca e Këshillit mbështetet në këtë liri – por është me shumë rëndësi të ceket se ndër dokumentet me të cilat funksionon Këshilli është edhe Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes që do të thotë se Këshilli funksionon me maximën që e drejta e njërit shtrihet deri aty ku preket e drejta e tjetrit.

⁴¹ <http://presscouncil-ks.org>

Këshilli është organi i dytë ku qytetari mund të drejtohet nëse ka ndonjë problem me ndonjë artikull në mediat e shkruara. I pari është gjithmonë shtëpia botuese.

Shkurtimisht:

1. Pas Këshillit si tërësi – organ relevant në lidhje me çështjet që ky ligj menaxhon është Gjykata Themelore
2. Gjykata Themelore shërben si organ i shkallës së dytë – pas ankesës që një qytetar mund ta parashtrijë në Këshill
3. Qytetari mund të parashtrijë ankesë në Këshill – në lidhje me ndonjë artikull, më pas Bordi i Këshillit vendos pro ose kundër ankesës.

Përfundime:

Sa i përket kornizës legislative të kategorisë së lirisë së shprehjes dhe mediave – përmbajtja legislative është më e thjeshtë dhe më koncize. Si pasojë e kësaj – është shumë e lehtë për akterët relevantë që të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në këtë pjesë është karakteristike se përveç kornizës legislative luan një rol të rëndësishëm edhe aspekti vetë-rregullues medial. Këtu bëhet fjalë për këshillin e mediave të shkruara të Kosovës i cili rregullohet brenda përbrenda dhe jo përmes legjislacionit – shprehimisht. Dallimi këtu qëndron në faktin se institucionet që rregullohen përmes legjislacionit (p.s.h KPM) i japin llogari Parlamentit. Përderisa institucionet që rregullohen vetë (KMSHK) i përgjigjen vetëm anëtarëve të vet’.

QASJA E PALËVE TË INTERESIT

Të gjithë jemi të prekur dhe të interesuar në lidhje me çështjen e privatësisë dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë. Megjithatë për arsye të perceptimit më të saktë dhe më të qartë në lidhje me çështjen në fjalë dhe mënyrën se si këto dy kategori legjislacioni lidhen mes vete dhe cila është qasja e palëve të interesit në këtë rast – kemi marrë përgjigjet e disa personave kyç në këtë proces, të cilët kanë të bëjnë me privatësinë dhe lirinë e shprehjes në baza ditore.

Njëra ndër të intervistuarat për këtë çështje është gazetarja Arbana Xharra nga gazeta Zëri.

Sipas Arbanës, në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nenet për sistemin e dosjeve dhe klasifikimin e të dhënave personale, janë dy nene të cilat lënë shumë hapësirë për keqpërdorim. Ato janë marrë si shabllone të ligjeve të huaja por nuk përcaktohen saktë procedurat e asgjësimit apo anonimizimit të të dhënave personale. Ajo tregon

që sipas disa prokurorëve dhe gjykatësve, mënyra se si janë frazuar këto dy nene lë mundësi të keqpërdorimit të të dhënave personale.

Për sa i përket eventeve/ngjarjeve mbi mbrojtjen e privatësisë, ajo thotë se kanë nisur në mënyrë më intensive si gazetë të merren me këtë temë, kur janë informuar se po përgatitej të kalojë në Kuvend ligji për përgjimin e telekomunikimeve. Në fillim është kërkuar që përgjimet të bëhen në çdo kohë dhe pa nënshkrimin e prokurorit. Dhe i vetmi operator që ka kundërshtuar me shkrim këtë ligj ka qenë operatori privat IPKO i cili ka konsideruar se cenohet privatësia e klientit dhe se kjo mund të dëmtojë rëndë kompaninë. Po ashtu ka pasur edhe reagime të tjera, por më pas për shkak të kundërshtimeve dhe reagimeve të mediave janë rishkruar amandamentet dhe është shtuar implikimi direkt i gjykatave pa nënshkrimin e të cilave nuk lejohet qasja në përgjime.

Sa i përket kapacitetit që ka Kosova të implementojë legjislacionin në fuqi zonja Xharra thotë që ka kapacitete të mjaftueshme, por nuk ka vullnet politik. Ndërsa ajo shton që në sektorin kyç kemi implikimin e grupeve të interesit dhe qasja e tyre e lehtë në sektorët që përbëjnë rrjetin e shtrirë në nivele qendrore dhe lokale e bëjnë të pamundur implementimin e drejtë dhe të pavarur të legjislacionit në fuqi.

E pyetur për njohuritë rreth legjislacionit që mbron lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave dhe lidhshmërisë në mes këtyre dy kategorive të legjislacionit (mbrojtja e privatësisë dhe liria e shprehjes dhe mediave) ajo tregon se legjislacioni që mbron lirinë e shprehjes dhe mediave ka lidhshmëri të madhe me privatësinë. Po ashtu shtron shqetësimin se cenimi i privatësisë dhe kapacitet e implementimit të ligjeve janë në stad ende aspak progresiv. Ajo shton se kemi të bëjmë me një ngecje që në heshtje është e pranuar nga të dyja palët; mediat dhe organet e drejtësisë. Po ashtu keqinterpretimi i lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së privatësisë ka mundësuar keqpërdorimin e hapësirës mediale dhe anasjelltas duke mos pasur trajtim ligjor konsistent të rasteve konkrete. Pra rritja e papërgjegjësisë së medias dhe mosndëshkimi nga gjykatat dhe prokuroritë kanë rezultuar me denigrim të vazhdueshëm dhe keqpërdorim të lirisë së shprehjes.

E intervistuar e radhës është drejtoresha e Shoqatës së Mediave të Pavarura Elektronike në Kosovë - Ardita Zejnullahu. Sipas saj mbrojtja e privatësisë në Kosovë, nuk është e rregulluar me ndonjë ligj të veçante, por pothuajse shumica e ligjeve në Republikën e Kosovës, e kanë nga një nen/nene ku adresohet mbrojtja e privatësisë. Duke filluar prej Kushtetutës, pastaj Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Drejtësisë për të miturit, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Familje, Ligji për Viktimat e Luftës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj. Ajo po ashtu thotë se ekzistojnë edhe një numër i institucioneve të specializuara në kuadër të të cilave rregullohet mbrojtja e privatësisë, si Komisioni i Pavarur i Mediave me rregulloret: *për Mbrojtjen e të Miturve dhe Kodin Etik Për Transmetuesit* si dhe Këshilli i Mediave me rregulloret: *për Mbrojtjen e të Miturve dhe Kodin Etik për Transmetuesit* si dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës me rregulloren *për Kodin Etik të Mediave Të Shkruara*.

Ajo thekson se nuk mund të kujtojë ndonjë ngjarje në veçanti me ndonjë ndikim domethënës, më tepër kjo çështje është trajtuar nëpër tryeza të ndryshme diskutimi, si pjesë përbërëse e ndonjë teme tjetër. Ajo shton se në rrafshin medial kjo çështje më së shumti është aktualizuar e diskutuar gjatë vitit 2011, në kohën e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, rasti Dell/Pacolli, sms e publikuar në media, diskutimi rreth privatësisë vs interesi publik.

Zejnullahu ngritë shqetësimin se Kosova edhe në këtë segment nuk beson që ka kapacitete të mjaftueshme për të implementuar legjislacionin në fuqi, duke filluar prej institucioneve bartëse e deri tek gjykatat. Ajo sugjeron që edhe pse në mungesë të një ligji specifik që rregullon këtë fushë, domosdo duhet të bazohemi dhe fuqizojmë legjislacionin në fuqi, gjithmonë duke i ndjekur standardet e Këshillit të Evropës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë fushë.

Ajo komenton se liria e shprehjes në Kosovë është e garantuar me Kushtetutë, si dhe ekzistojnë një varg ligjesh që mbrojnë dhe promovojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në përgjithësi. Ajo shpjegon se ligji për Komisionin e Pavarur për Media dhe ligji për Radio Televizionin e Kosovës janë dy ligje bazike që rregullojnë fushën e mediave në përgjithësi. Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për të Drejtat e Autorit, Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Digjitalizimin e Transmetimeve etj.

Ajo shtron problemin që edhe pse infrastruktura ligjore ekziston - ky fakt nuk garanton implementimin e mirëfilltë të këtyre ligjeve. Liria e shprehjes dhe liria e mediave, shpesh janë të rrezikuara nga zbatimi i dobët i ligjeve, sistemi gjyqësor jofunksional, institucionet publike të politizuara etj.

Ajo mbështetë qëndrimin se duhet të ketë lidhshmëri në mes të mbrojtjes së privatësisë dhe lirisë së shprehjes dhe mediave, për faktin se këto dy segmente kompletojnë njëra tjetrën dhe në shumë vende rregullohen në kuadër të një ligji të vetëm. Ajo sugjeron që edhe ne duhet të bazohemi në praktikat më të mira për mbrojtjen e privatësisë, duke pasur gjithmonë parasysh interesin publik për çështjet e caktuara dhe baraspeshën mes këtyre dy kategorive.

Besa Luci nga Kosovo 2.0 si nismë që ka bërë ndryshim në trajektoren mediale në Kosovë, konsideron gjithashtu se në përgjithësi njerëzit kanë njohuri të paktë në lidhje me kornizën legjislative që rregullon privatësinë në Kosovë. Ajo përmend Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale si ligjin kryesor që rregullon këtë çështje.

Ndër të tjera, edhe Luci përmend se nuk kujton ndonjë ngjarje specifike në lidhje me privatësinë në Kosovë. Rreth kësaj ajo thotë se në përgjithësi në Kosovë nuk ka diskutim të mirëfilltë në lidhje me këtë çështje dhe gjithashtu dhe as vetëdijesim të mjaftueshëm shoqëror mbi legjislacionin në fuqi.

Edhe Luci njësoj sikur të intervistuarit e tjerë konsideron se ka mos-përputhje në mes të ligjeve në fuqi dhe shpeshherë institucionet përdorin një ligj për të shmangur implementimin e tjetrit. Kjo ndodh kryesisht me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjin për qasje në dokumente publike.

Imer Mushkolaj në cilësinë e kryetarit të bordit të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës kujton dy ngjarje të organizuara në lidhje me privatësinë dhe mbrojtjen e saj në Kosovë – e që janë fushata “Privatësia në epokën digjitale” dhe një aktivitet organizuar vitin e kaluar për shpërndarjen e broshurave – të dyja këto të organizuara nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Z. Mushkolaj përmend faktin se përkundër ligjeve të bollshme - megjithatë Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme për implementimin e legjislacionit në fuqi.

Arianit Dobrosi nga FLOSSK ka qenë një prej më të zëshmeve në lidhje me çështjen e privatësisë e sidomos ligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike⁴². Ai konsideron që Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale ofrojnë mjaftueshëm material për përgjime në mënyrë të duhur, kurse ligji për përgjimin e komunikimeve elektronike është bërë vetëm për të mbajtur të dhëna dhe për të vazhduar mundësinë e AKI-së për përgjime.

Përfundime: Suma summarum – nga intervistat me të gjithë pjesëmarrësit që i kemi identifikuar si relevant dalin tre rekomandime të përbashkëta:

1. Duhet punuar në ngritjen e nivelit të njohurive në lidhje me kornizën ligjore sa i përket privatësisë dhe lirisë së shprehjes – por veçanërisht privatësisë
2. Duhet ngritur kapacitetet për implementimin e legjislacionit në fuqi
3. Mbrojtja e privatësisë dhe liria e shprehjes duhen parë si dy fusha komplementare që plotësojnë njëra tjetrën e jo si përjashtuese

⁴² <https://arianit2.wordpress.com/2014/05/01/ëhy-kosovos-neë-draft-laë-on-interception-is-still-ërong/>

PËRDHUNIMI I PRIVATËSISË VS LIRIA E SHPREHJES – 3 DËSHTIMET E KOMBINIMIT:

Në pjesën e mësipërme të këtij punimi – gjegjësisht në pjesën më të madhe të tij është sjellë tek lexuesi pjesa teorike e privatësisë dhe lirisë së shprehjes e mediave. Megjithatë – për ta plotësuar këtë pjesë teorike me ilustrime praktike në këtë pjesë do të sjellim tre raste që do t'i shqyrtojmë. Duke ditur që këto tre raste nuk janë të vetmet dhe mbase jo edhe më të rëndësishmet – kemi zgjedhur këto të tria për arsyen e ndjeshmërisë së madhe të rasteve.

Rasti i Hamdi Sopës

Rasti i Hamdi Sopës është njëri prej rasteve më të ndjeshme – me përcjelljen e të cilit media ka dështuar të respektojë privatësinë e familjes dhe në ndërkohë ka shkelur me të dy këmbët parimin e prezumimit të pafajësisë. Ky është rasti perfekt i dështimit të kombinimit privatësi dhe liri e shprehjes. Në këtë rast që ka ndodhur në vitin 2013 – mijëra artikuj nga media të ndryshme (pa përjashtim) në Kosovë përdhosin deri në fund privatësinë e familjes Sopa duke shkruar pafund se si i ndjeri Hamdi ishte shtyrë nga ballkoni nga vajzat e tij. Disa media shkojnë aq larg sa të paragjykojnë arsyet se pse vajzat dhe bashkëshortja e donin babanë respektivisht bashkëshortin e vdekur.

Përkundër faktit që më pas dalin të dhëna të reja që realisht ekspertiza tregon se rasti nuk ka pasur të bëjë me vrasje por ka qenë vetëvrasje (vëmendje: rasti është akoma në proces kështu që s'mund të paragjykojmë rezultatin), prapëseprapë dëmi është bërë. Artikulli i fundit i shkruar në lidhje me këtë rast daton në gusht të vitit 2013, përkundër faktit që ka pasur zhvillime të reja. Media nuk ka hezitur të përdhosë privatësinë e familjes, të paragjykojë rezultatin, të shkelë prezumimin e pafajësisë për muaj me radhë – por ka shkruar 1 apo 2 artikuj në lidhje me faktin se vajzat e të ndjerit janë liruar nga paraburgimi pas gati 200 ditësh në burg.

Rasti i Hamdi Sopës është treguesi kryesor i keqpërdorimit të lirisë së shprehjes dhe realisht i mos-funksionimit të sistemit i cili do të duhej të merrte masa ndaj proceseve të tilla. Sot – 3 vite më pas nëse shohim mbrapa vërejmë se si media ka shkatërruar jetën e një familjeje të tërë – krejt kjo për shkak të përzierjes së koncepteve.

Dënimi i parë me burgim të përjetshëm

Rasti i dytë ka të bëjë me dënimin e parë me burgim të përjetshëm që është dhënë në Republikën e Kosovës. Për herë të parë prej hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Penale që parashikon dënimin me burgim të përjetshëm – u dha një dënim i tillë në Kosovë më 11 Shtator 2015. Dënimi u dha për vrasje të rëndë. Në rastin në fjalë, ishte

pjesëmarrëse edhe një e mitur – emri i të cilës u shkoi mediave i plotë në komunikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke anashkaluar kështu komplet atë që përcakton Kodi i Drejtësisë për të Mitur:

Për t’iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur⁴³.

Siç edhe është pritur, pas publikimit të deklaratës nga vetë sistemi, gati të gjitha mediat morën dhe publikuan emrin e plotë të të miturës duke shkelur kështu privatësinë e saj (dhe njëkohësisht ligjin) në tërësi.

Ky rast është me rëndësi të madhe sepse paraqet anën tjetër të medaljes dhe tregon se jo vetëm mediat dinë të keqpërdorin lirinë e shprehjes, por sistemi vetë e keqpërdor’ apo keqinterpretton atë ndonjëherë. Edhe ky rast është një dështim i kombinimit privatësi dhe liri e shprehjes në Kosovë.

Rasti i Albulena Haxhiut

Rasti i tretë ka të bëjë me skandalin e fundit të publikimit të të dhënave mjekësorë të Albulena Haxhiut. Gjatë këtij viti – në vazhden e avarisë së bllokadës parlamentare dhe dështimit të vazhdueshëm për të parë se si po futet gazi lotsjellës në Kuvend – Albulena Haxhiu – njëra nga deputetet e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvend përfundon në spital për shkak të disa lëndimeve trupore.

Një prej medimeve në Kosovë siguron një rëntgen të deputetes të cilin e publikon të tërë pa hezitim dhe madje edhe e interpreton duke thënë se gazi lotsjellës i është gjetur deputetes në organet e saj gjinitale.

Këtë lajm (nëse mund të quhet i tillë) e përvetësojnë shumica e mediave në vend dhe përkundër faktit që nuk është i saktë në tërësinë e tij dhe se shkel privatësinë e deputetes dhe dëmton reputacionin e saj – vazhdon të përhapet me të shpejtë.

Ky është rreziku i jetesës në epokën digjitale – askush më nuk ka kontroll mbi përhapjen e informatës pas momentit kur ajo del online. Është shumë e lehtë të publikosh diçka – por tejet e vështirë të ndalosh ndikimin e publikimit dhe përhapjen e tij.

Ky rast është mbase me eklatanti kur vije te shkelja e privatësisë sepse në këtë pikë përveç privatësisë së deputetes në lidhje me publikimin e të dhënave private, shkelen edhe parimet themelore të etikës profesionale.

⁴³ <http://www.kosovopolic.com/repository/docs/2010-193-alb.pdf>

Si përfundim, këto raste janë tre nga të shumtat raste që kanë ndodhur e që vazhdojnë të ndodhin në vendin tonë e që kanë të bëjnë me shkeljen e privatësisë dhe lidhjen e zhdrejtë që kjo e fundit ka me lirinë e shprehjes dhe të mediave. Kjo nuk duhet marrë si indikacion se nuk ka gazetari të mirëfilltë apo se media gjithmonë keqinterpretton privatësinë dhe lirinë e shprehjes. Megjithatë raste të tilla janë indikator i rëndësishëm që tregon se përkundër faktit që në Kosovë ka media shumë profesionale, akoma ka paqartësi të madh rreth asaj se çka është privatësia, cilat ligje e rregullojnë atë dhe deri ku shtrihet liria e shprehjes. Ky punim tenton të sjellë dritë mbi këto çështje. Megjithatë drita që ky punim sjellë është thjeshtë teorike. Hipotetakisht – edhe po u qartësua në tërësi çështja e kornizës legjislative në vend – kjo nuk ka shumë rëndësi në rast se sistemi akoma do të vazhdojë të jetë jo-funksional dhe në deficit të kapacitetit për adresim të këtyre rasteve.

REKOMANDIME

Nga të gjitha vrojtimit e bëra më lartë – vijmë në përfundim se privatësia dhe liria e shprehjes dhe mediave akoma ka raste kur funksionojnë si kategori përjashtuese. Megjithatë për të gjetur një vijë të drejtë bashkëpunimi – dhe për të përmirësuar jo vetëm aspektin e privatësisë por edhe të raportimit bazuar në lirinë e shprehjes – duhet ndërmarrë disa hapa nga të gjithë pjesëmarrësit. Kjo nënkupton që ndryshimet duhet të vijnë si prej sistemit legjislativ, ashtu edhe prej sistemit ekzekutiv, gjyqësor e mediave:

- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të përditësohet ashtu që të përfshijë standardet dhe rregullat e përditësuara të Direktivës dhe Rregullores së re të Bashkimit Evropian.
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ende duhet të vazhdojë të ndërmarrë hapa drejt vetëdijesimit të qytetarëve por edhe institucioneve jo vetëm për të drejtat mbi privatësinë e të dhënave, por edhe për punën e vetë Agjencisë.
- Duhet ushtruar presion në Kuvend për miratimin e zyrtarëve të rinj të Agjencisë si kusht i nevojshëm për ngritjen e efikasitetit të saj.
- Progres shumë i limituar është bërë për të përmirësuar llogaridhënien dhe shërbimet publike. Ligjet për procedurën administrative dhe aktet nënligjore ende nuk janë kompletuar.
- Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike mbetet i pakënaqshëm. Kosova po ashtu ka nevojë të rishikoj organizimin e administratës publike në nivelin lokal, sidomos në delegimin e kompetencave dhe në emërimin e drejtorëve.
- Thjeshtëzimi dhe riorganizimi: ligjet, rregulloret relevante si dhe aktet e brendshme janë shumë të paorganizuara dhe komplekse, duke e bërë të vështirë për bizneset të kuptojnë obligimet e tyre dhe për individët t'i dinë të drejtat e tyre. Një ristrukturim bazik është i nevojshëm.
- Të përditësohet Ligji Civil për Shpifje dhe Fyerje dhe të përcaktohet periudhë kohore brenda të cilës duhet kryer rastet e tilla sepse dëmtimi i reputacionit nuk ka çmim.
- Të amandamentohet Ligji për Mbrojtjen e Informatorit në mënyrë të tillë që të garantojë anonimitetin e informatorit dhe të krijojë mekanizma të sigurt ku të paraqitet informata si dhe dispozita të sakta mbi procedurën kur shkelet anonimiteti i personit së ka informuar mbi një keqpërdorim.

- Të rregullohet me akte ligjore fushë veprimtaria e mediave/portaleve online në kontekstin e trajtimit të integritetit dhe të dhënave të ndjeshme personale gjatë veprimtarisë së tyre.
- Rrezikimi i privatësisë nga bota online: Telefonat tonë mobil tabletët apo gjëra të tjera që ne i bartim me vete, jo vetëm që na lejojnë të argëtojmë vetveten, por me një përdorshmëri shumë të madhe sot ata gjithashtu ofrojnë një shumëllojshmëri të aftësive tjera. Aplikacionet mobile për telefona na lejojnë neve jo vetëm të lexojmë libra, dëgjojmë muzikë dhe të marrim foto dhe video, por gjithashtu të monitorojmë rrahjet e zemrës, ta ndezim makinën nga distanca në një natë të errët, të gjejmë një restorant afër dhe të bëjmë pagesa online. Me funksionet e tyre të zgjeruara telefonat tonë mobil janë subjekt i rrezikshëm për privatësinë nga bota online në gjithë botën. Në Kosovë nuk ekziston një ligj të na mbrojë apo informojë për rreziqet që mund të na vijnë nga aplikacionet e ndryshme që ne përdorim.

Kontakti:

LENS

ADRESA: Rruga Sylejman Vokshi 25 2nd floor Nr 6, 10000, Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 74 81 50

info@ngolens.org

KCIC

Adresa: Kosovo, 60000, Gjilan, Rexhep Dajkovci, 48 Tel. +377 (0)44 177 320

Tel. +386 (0)49 880 447

E-mail: ngo.kcic@gmail.com ose info@ngo-kcic.org



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Evropian në Kosovë

Zbatuar nga:

